

Vizatim i Diktuar

Vlerat

Bashkëpunimi, Komunikimi, Disiplina, Durimi dhe Krijimtaria.

Qëllimet

Pedagogjike: Inkurajimi i krijimtarisë në gjetjen e mënyrave për të komunikuar, duke njohur nevojat e ndryshme për informacion, duke kapërcyer paragjykimet dhe duke analizuar kufizimet që sjell komunikimi i njëanshëm.

Praktike: Riprodhimi i vizatimit sa më saktësisht të jetë e mundur përmes komunikimit verbal.

Pjesëmarrësit

Minimumi: 4 pjesëmarrës
Maksimumi: 30 pjesëmarrës
Rekomandohet: 10 deri 12 pjesëmarrës

Kohëzgjatja

20 deri 40 minuta

Materialet

Stilolapsa ose lapsa
Fleta të bardha
Fletë me vizatimin që duhet të kopjohet

Përmbledhje

Klasa ndahet në grupe me nga dy nxënës të cilët ulen të kthyer me kurriz nga njëri-tjetri pa u prekur. Mësuesi shpërndan fletën me vizatimin dhe ia jep njërit prej nxënësve në grupet dyshe (vizatimi do të zgjidhet nga mësuesi/ja në varësi të moshës së nxënësve dhe karakteristikave të klasës). Nxënësi që merr në dorë vizatimin do të përpiqet t'ia përshkruajë atë shokut/shoqes së tij që do të vizatojë sipas përshkrimit që dëgjon. Nxënësi që vizaton nuk mund të flasë, të pyesi ose të sugjerojë asgjë. Në këtë fazë, komunikimi është vetëm në një drejtim (i njëanshëm) dhe është i kufizuar në lidhje me përshkrimin e vizatimit, ndërkohë që nxënësi po diktonte për shokun tjetër. Kur të gjitha grupet përfundojnë, fillon një fazë e dytë e aktivitetit. Pa treguar vizatimin origjinal, studenti që diktoi tani mund të jetë ballë për ballë me shokun e tij dhe përshkruan të njëjtin vizatim; të dy nxënësit tani mund të komunikojnë lirshëm. Ata mund të bëjnë pyetje, të japin sugjerime ose të japin ndonjë shpjegim tjetër rreth vizatimit. Në fund, ata mund të tregojnë vizatimet e bëra dhe atë origjinal dhe të shohin dallimet.

Shënime

Nxënësve duhet t'u sqarohet mirë që deri në fund të fazës së parë të aktivitetit nuk mund të shikojnë ose pyesin shokun/qen që përshkruan vizatimin, dhe ata që diktojnë duhet të përpiqen të përdorin një gjuhë sa më të qartë, të saktë dhe të përshtatshme për t'u kuptuar lehtë. Nëse mbetet akoma kohë, sugjerohet që studentët të shkëmbejnë rolet (vizatim/diktim) me njëri-tjetrin. Sa më komplekse janë vizatimet, më të përshtatshme janë për nxënësit më të rritur.



Vizatim i Diktuar *(vazhdimi)*

Treguesit e vëzhgimit

1. A ishin studentët të përqendruar vetëm në udhëzimet e shokut/qes së grupit, apo po kërkonin edhe nxitës të tjerë të jashtëm (nga grupet e tjera)?
2. Pëprara sesa të fillonin përshkrimin e vizatimit, kishte nxënës që menduan për të planifikuar mënyrën e shpjegimit të vizatimit shoku/qes së tyre, apo filluan ta përshkruajnë menjëherë?
3. Sa të ndryshme ishin nevojat për informacion midis grupit të nxënësve që po vizatonin?
4. Si e vlerësuan nxënësit përparimin e tyre nga faza e parë në fazën e dytë - më shumë në bazë të zhvillimit të komunikimit apo në rezultatin e dukshëm të vizatimit? Janë të dukshme dallimet midis vizatimit të parë dhe të dytë?
5. Në fazën e dytë, i treguan nxënësit njëri-tjetrit vështirësitë që kaluan në fazën e parë? A e ndryshoi mënyrën e të diktuarit nxënësi që përshkroi vizatimin kur ata mund të shikonin njëri-tjetrin dhe të përdornin dhe gjestet e trupit? Cilat janë dallimet midis shprehjes verbale dhe të trupit në të dy fazat? A përdorën ata metafora për të përshkruar vizatimin apo përdorën më shumë metodën përshkruese për vizatimin?

Diskutimi

Para se të fillonit përshkrimin e vizatimit, kaluat kohë për të planifikuar se si do t'ia përshkruanit atë shokut/qes tuaj apo donit të fillonit menjëherë me përshkrimin? (për studentët që diktuan vizatimin), a përshkruat fillimisht idenë e përgjithshme të vizatimit apo filluat me pjesët / elementët e veçantë të tij? Pse?

A ishit i/e përqendruar vetëm në udhëzimet e shokut/qes tënde të grupit apo konsiderove edhe informacione që dëgjoje nga grupet e tjera?

Kush përdori metaforë për të përshkruar vizatimin? Për cilat pjesë?

Mendoni se fjalët e përdorura nga shoku/qja juaj e grupit ishin të sakta, të qarta dhe objektive (dimensionet, forma etj.)? Pse(jo)? Për çfarë lloj informacioni kishit më shumë nevojë?

Mendoni se ndryshimet midis vizatimit të parë dhe të dytë ishin të dukshme? Pse (jo)?



Vizatim i Diktuar

Pikat e vëzhgimit dhe Rregjistrimit

1. Vëmendje dhe përqëndrim

Mendoni se studentët i kushtuan vëmendje udhëzimeve të dhëna dhe u përqëndruan te aktiviteti? *Shumë 1-2-3-4-5-6-7-8-9-10 Aspak*

Çfarë dëgjuat nga nxënësit për të arritur në këtë përfundim?

Çfarë patë për të arritur në këtë përfundim?

Tani largoje veten nga ato që shikove/dëgjove dhe përkruaj mënyra të tjera të mundshme për të rritur vëmëndjen e nxënësve në lidhje me instruksionet.

2.Strategjia dhe Planifikimi

Mendoni se nxënësit që diktuan vizatimin përcaktuan një strategji ose bënë ndonjë planifikim përpara sesa ta fillonin?

Po 1-2-3-4-5-6-7-8-9-10 Jo

Çfarë dëgjuat nga nxënësit për të arritur në këtë përfundim?

Çfarë patë për të arritur në këtë përfundim?

Tani largoje veten nga ato që shikove/dëgjove dhe përkruaj mënyra të tjera të mundshme që nxënësit të planifikojnë detyrat.

3. Përfshirja


Çfarë informacioni mendoni se kishte nevojë nxënësi që vizatonte?

Shumë të detajuar 1-2-3-4-5-6-7-8-9-10 Pak të detajuar

Çfarë dëgjuat nga nxënësit për të arritur në këtë përfundim?

Çfarë patë për të arritur në këtë përfundim?

Tani largoje veten nga ato që shikove/dëgjove dhe përkruaj mënyra të tjera të mundshme që nxënësit të marrin pjesë pozitivisht në detyrat.



Vizatim i Diktuar

Pikat e vëzhgimit dhe Rregjistrimit

4. Vlerësimi i ecurisë

E vlerësojnë nxënësit ecurinë grupit të tyre në mënyrën e duhur?

Pozitivisht 1 – 2 – 3 – 4 – 5 – 6 – 7 – 8 – 9 – 10 Negativisht

Çfarë dëgjuat nga nxënësit për të arritur në këtë përfundim?

Çfarë patë për të arritur në këtë përfundim?

Tani largoje veten nga ato që shikove/dëgjove dhe përshkruaj mënyra të tjera të mundshme që nxënësit të vlerësojnë ecurinë në detyrat.

5. Komunikimi

Si i komunikuan nxënësit përshkrimet e vizatimeve të tyre dhe vështirësitë që hasën (në fazën e dytë)?

Pozitivisht 1 – 2 – 3 – 4 – 5 – 6 – 7 – 8 – 9 – 10 Negativisht

Çfarë dëgjuat nga nxënësit për të arritur në këtë përfundim?

Çfarë patë për të arritur në këtë përfundim?

Tani largoje veten nga ato që shikove/dëgjove dhe përshkruaj mënyra të tjera të mundshme që nxënësit të komunikojnë mendimet e tyre rreth ecurisë së detyrave.

Së fundi, bëhuni kurioz dhe jini të hapur për të ditur se çfarë kanë për të thënë nxënësit për 5 pikat e mësipërme!!

